



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 07.03.2025
Numër i Protokollit: 1582/2025

A.nr.138/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.138/2025 të datës 20.01.2025 të parashtruar nga ankuesja B.M., kundër organit të punësimit Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*Kontestim Konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.138/2025 të datës 20.01.2025 të parashtruar nga ankuesja B.M.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil B.M. (në *tekstin e mëtejme referuar* ankuesja), më datë 20.01.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e pranimin me numër reference RN00015138 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës Inspektor i Punës Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit, të shpallur nga Inspektorati i Punës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 04.03.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.138/2025, **sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 13.09.2024 ka shpallur konkursin me Nr.reference RN00015138 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit klasa Profesional 1, numri i kërkuar 6 vende, me afat aplikimi 14.09.2024 deri 13.10.2024.

Tutje në këtë konkurs, kanë aplikuar 159 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa, e cila e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa, e njëjta i është nënshtruar edhe fazës së testit me shkrim, ku në këtë fazë ka marrë 48 pikë, nga rrjedh se ankuesja nuk ka arritur t'i marrë pikët e mjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë.

Ankuesja, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor se gjatë testit me shkrim kam parë shumë parregullsi në formulimin e tij pyetjet nuk korrespondojnë me opsionet që kishim në përgjigje, kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa konkursin me numër Reference RN00015138, për pozitën Inspektor i Punës të anulohet.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati, V. A., si kandidat aplikuesë në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015138, më datë 22.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë të pranimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.166/2025 të datës 07.03.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015138 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht pozitën Inspektor i Punës në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.138/2025 të datës 20.01.2025, ka të bëjë me kontestimin e procedurës së njëjtë të pranimit, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.166/2025 të datës 07.03.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015138, si një qëllim i propozuar nga ankuesi në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i ankesës A.nr.138/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.138/2025 të datës 20.01.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.138/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses B.M;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.